

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjirokastrë - Turi i Ripërtërimit/ PD nis aksionin në terren, Noka: Situata dramatike, kërkohet qeveri teknike
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919454/turi-i-riperteritjes-pd-nis-aksionin-ne-teren-noka-situata-dramatike-kerkohet-qeveri-teknike/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 08:43:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 08:11:59 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	09f23fb0f5e6241692bfc7471afa7c17f38f1dbc0018a0fdd905fbf914ee8721
TEKSTI	240154338c30ce2b6796ad95ba458166fb6fed7d035c67b19c1b9cc9ff0fdf09
PAMJA	1e0d5ddcae8474a580c85e99b02c9fa7a7888ff055fcdd963e32491b38de849c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8b99016cca7489e6d2d279cf52c53e0e2053a1b15752d566f16ce9f74ab3b245
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b15fa4fb9899cfd04d55deb4808016b106f413d91b2f45c6fda6eeee1406fd0e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8b99016cca7489e6d2d279cf52c53e0e2053a1b15752d566f16ce9f74ab3b245>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**FATMIR MEDIU**

Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk iu kundërvu Vuçiçit dhe zgjodhi të flasë për Diellën

**NDRIÇIM KULLA**

Dorëheqja e Ramës, kërkesë edhe e ndërkombëtarëve



më të lexuarat

'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s' menaxhon dot më

VIDEO/ Balliu: A ka folur Edi Rama me Ergys Agasin përmes telefonit të Vlora Hysenit?

Berisha: Vlora Hyseni është kthyer për t'u dhënë restin bashkëpunëtorëve të vet që e tradhtuan

'Garancia e plotë' e Ramës dhe përgjegjësia e tij politike për Vlora Hysenin

Fjalimi i turpshëm në OKB/ Berisha: Rama, armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër VV-së

'Zullumi po e kap për fyti Ramën', Noka në Tepelenë: Skandalet e kanë zhveshur totalisht



Turi i Ripërtëritjes/ PD nis aksionin në terren, Noka: Situata dramatike, kërkohet qeveri teknike

10:11, 27/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Partia Demokratike ka nisur zyrtarisht turin e saj mbarëkombëtar, me fokus ripërtëritjen, organizimin dhe forcimin e strukturave të partisë. Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Demokratike, Flamur Noka, zhvilloi takimin e parë të këtij turi në qytetin e Gjirokastrës, ku u takua me drejtuesit lokalë, strukturat dhe anëtarësinë demokrate.

Në qendër të takimit ishte organizimi i brendshëm i partisë, mobilizimi i bazës dhe analiza e situatës politike në vend. Noka kërkoi angazhim më të madh të strukturave dhe ngritjen e Partisë Demokratike në lartësinë e detyrës përballë sfidave politike që po përballët Shqipëria.

Gjatë fjalës së tij, Noka e cilësoi situatën aktuale politike dhe ekonomike tejet dramatike, duke akuzuar qeverinë dhe kryeministrin Edi Rama për një sërë skandalesh dhe për mungesë përgjegjësie ndaj qytetarëve.

"Sot Edi Rama dhe qeveria e tij janë kthyer në një problem të madh për vendin, ku skandalet që prodhohen çdo ditë dëshmojnë mungesën e çdo sensi morali dhe përgjegjësie", u shpreh Noka.

Sekretari i Përgjithshëm i PD-së deklaroi se qeverisja aktuale dhe lidhjet që ekzistojnë me krimin e organizuar përbëjnë një barrë të rëndë për vendin. Ai akuzoi mazhorancën se ka dëmtuar funksionimin e institucioneve dhe se qytetarët po përballen me pasojat e situatës politike dhe ekonomike.

Një tjetër pikë e rëndësishme e mesazhit të Nokës ishte nevoja për garantimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Sipas tij, krijimi i një qeverie teknike përbën zgjidhjen e propozuar nga opozita për të garantuar një proces zgjedhor të besueshëm dhe për t'i dhënë fund kapjes së institucioneve.

Noka: Ripërtëritja e PD-së nis aksionin në terren, kërkohet qeveri teknike

NOKA Kërkon gjyfashtu forcimin e organizimit te opozites ne te gjithe vendin, duke e paraqitur turin si një proces që nuk do të kufizohet vetëm në takime me strukturat, por do të shërbejë edhe për analizimin e situatës në çdo degë dhe për mobilizimin e anëtarësisë.

"Misioni i Partisë Demokratike është të ngrihet në lartësinë e detyrës për t'u bërë ballë sfidave të kohës, për t'u forcuar dhe për t'i dhënë vendit një drejtim të ri politik", ishte mesazhi i përcjellë nga Noka.

Turi mbarëkombëtar do të vijojë në degët e PD-së në të gjithë Shqipërinë. Në fokus do të jenë riorganizimi i strukturave, forcimi i lidhjes me anëtarësinë, analiza e situatës politike dhe përgatitja e opozitës për aksionin e ardhshëm politik.



Berisha: Rama kërkon t'i paraqesë shqiptarët si antisemitë, terroristë e çdo gjë tjetër vetëm që të qëndrojë në pushtet

Berisha: Sulmi i Ramës ndaj Joe Biden për dënimin e Thaçit është një paturpësi ekstreme

'Qeveria braktisi qytetarët përballë çmimeve', aktivisti: Shqipëria mban TVSH-në 20% për shportën bazë







Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.